



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

15.08.2024

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “NOVATECH STUDIO” SHPK**

TIRANE Njesia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica, nr pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, hyrja 1, ap 18

Procedura e prokurimit/lotit: **e hapur e thjeshtuar - Shërbime - Prokurim me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-12937-07-11-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Supervizion punimesh Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3 (2024) me fond limit: 1,931,083.02 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tre presje zero dy) Lekë, pa TVSH**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **6 muaj e 2 javë**

Publikimet e mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 15 Korrik 2024, Nr. 37**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “ZENIT&CO” SHPK

K61731002D

Vlera: **1,877,012** (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dymbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **264.00**

2. BOE “TAULANT” & “E.B.S”

K61617040L/ K72014002P

Vlera: **1,800,000** (një milion e tetëqind mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

3. BOE “NET-GROUP” SHPK + “UNITEC-STUDIO” SHPK

L72023002P / K72316010C

Vlera: **1,760,000** (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

4. BOE “LENI-ING” SHPK + “ANGERBA” SHPK

J88730334W / L01322018T

Vlera: **1,534,960** (një milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

5. OE “NOVATECH STUDIO” SHPK

L01717030C

Vlera: **1,686,765.35** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje tridhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **276.00**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik BOE “LENI-ING” SHPK + “ANGERBA” SHPK, pasi oferta ekonomike me vlerë 1,534,960 lekë (pa tvsh), e paraqitur nga ky operator është poshtë vlerës minimale të lejuar kjo në kundërshtim me vendimin Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe rekomandimin Nr. 5585, datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik”

2. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “BOE “TAULANT” & “E.B.S” pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 %** e vlerës së përlllogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori ekonomik ”EBS” shpk duke ju referuar përqindjes pjesmarrëse në kontratën e bashkëpunimit nuk ka paraqitur punë të ngjashme me natyrën e objektit që prokurohet,

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. OE “Taulant”shpk nuk disponon stafin e nevojshëm mbikëqyrës për realizimin e kësaj kontrate pasi stafi i propozuar për këtë procedurë është i angazhuar në kontratë tjetër në proces ndërtimi të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar kjo në kundërshtim me pikën:

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

3. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik BOE “NET-GROUP” SHPK + “UNITEC-STUDIO” SHPK pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbikëqyrës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë, sipas kërkesave të DST

-Stafi i paraqitur nga bashkimi i operatorëve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit kjo në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, Vendimit 285, date 19.05.2021 pika 3.“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “NOVATECH STUDIO” SHPK, me adresë: TIRANE Njesia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica, nr pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, hyrja 1, ap 18, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,686,765.35** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje tridhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH..** / totali i pikëve të marra **276.00** është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR**, adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Faks : +355 4 2234487, E-mail: info@arrsh.gov.al

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli